

20020610944

LIGJI
PËR HYRJEN NË BORXH TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË NDAJ BANKA
EVROPIANE PËR REKONSTRUIMIN DHE ZHVILIMIN SIPAS MARRVESHJES PËR
KREDITIN TË PROEKTIT TË PËRPARIMIT TË LUNDRIMIT AJROR CIVIL

Neni 1

Republika e Maqedonisë hyri në borxh ndaj Bankës Evropiane për rekonstruimin dhe zhvillimin me:

- kredit me vlerë se 11,2 milione Euro dedikuar për realizimin e proektit të përparimit të Lundrimit ajror civil, të cilin përbehet nga furnizimi i mjetëve për lundrimin së terësishëm të hapësirës ajrore së Republikës së Maqedonisë dhe modernizimin e pistës së Aeroportit të Ohrit.

Neni 2

Afati për pagesës së kreditit prej nenit 1 të këtij ligji është 12 vjet me grejs periudhë prej tre vitesh dhe shkalla variable tatimore - EURIBOR plus 1 përqind.

Kreditin do të pagohet me kështë të njëjtë gjysmëvjetore të cilat arrijnë për pagim më 16 mars dhe më 16 shtator çdo vit, duke filluar më 16 mars viti 2006, kurse duke mbaruar më 16 shtator viti 2014.

Pas efikasitetit të kreditit do të pagohet provizion i njëfishtë prej 1 % për drejtim me kreditin derisa e pjesës së jotërhequr së mjeteve do të pagohet provizion nga 0,5 % në vit.

Neni 3

Shfrytëzuesi i fundit të kreditit është Drejtoria e Lundrimit ajror civil, organi në përbërjen e Ministrisë së transportit dhe lidhjes.

Neni 4

Kreditin prej nenit 1 të këtij ligji do ta pagojë Drejtorinë e Lundimit ajror civil prej të ardhurave që i realizon nga pagesa nga mbi fluturime të aeroplanëve ndaj teritorit të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me rregullat të Eurokontrollit (Organi i ekzekutuar të Organizatës ndërkombëtare së aviacionit civile) me selin e Brukselit.

Neni 5

Subjektet trashëgimtare e Drejtorisë së lundrimit ajror civil do të vazhdojnë ta paguajnë kreditin prej ardhurave të vetë, në afate dhe kushte të caktuara me Marrveshjen e kreditit.

Neni 6

Ministria e financave do të paguajë nga shfrytëzuesi i fundit provizion në lartësi nga 1 % mbi llogarit të shkallës së kamatës si kompenzim për ekspozitimin e kreditit të RM - së ndaj botës. Mjetët e grumbulluara sipas kësaj bazës do të jenë të ardhurat të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Derisa anuitetet e arritura në afatët të përcaktuar me Marrveshjen e kreditit, në emër të shfrytëzuesit të fundit i pagoi RM - së, ministri i financave, 30 dite pas kryerjes së obligimit, por jo më vonë se 60 dite, do t'u publikojë urdhër e Bankës Popullore së Republikës së Maqedonisë ose Bankës afariste ku shfrytëzuesi i fundit ka llogarit në denarë, të transmetojë prej llogarisë së

shfrytëzuesit të fundit të kreditit në favor të llogarisë së ardhurave së Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, mjetët në denarë në lartësinë e pagimit të kryer, i rritur për kamatës së llogaritur dhe për harxhimet.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi nga dita e tetë prej shpalljës në “Gazetën zyrtare e Republikës së Maqedonisë”.